



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FINIQ-DROPULL

Nr. 319 / prot.

FinIQ, më 29.09.2022

NJOFTIM PËR PUNËSIM

PËR POZICIONIN MËSUES PROFILI Edukim Fizik (Kurrikula Shqip dhe Greqisht).

NË AFATIN: Kontratë 3-mujore dhe pas kalimit me sukses të tremujorit të kohës së provës kontrata do të rinovohet deri në përfundim të vitit shkollor 2022-2023,
Pozicioni i punës: 12 orë profili në Shkollën 9-vjeçare Finiq dhe 10 orë profili në Shkollën 9-vjeçare Mesopotam.

Në mbështetje të Ligjit 69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Urdhërit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 31, datë 28.01.2020 "Për Miratimin e Rregullores për Funksionimin e Institucioneve Arsimore", Udhëzimit nr.12, datë 10.06.2021 "Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë" ndryshuar me Udhëzimin nr.28, datë 03.08.2022 të MAS "Për një ndryshim në udhëzimin nr.12, datë 10.06.2021 "Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë", i ndryshuar", Udhëzimit nr. 30, datë 12.09.2018 "Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar" ndryshuar me Udhëzimin nr. 25, datë 01.08.2022 të MAS "Për disa ndryshime në udhëzimin nr.30, datë 12.09.2018, "Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar", i ndryshuar", Udhëzimit nr.20, datë 19.07.2022 "Për përcaktimin e lëndëve mësimore që zhvillohen në gjuhën shqipe dhe në gjuhën amtare nga nxënësit e pakicave kombëtare në arsimin bazë në Shqipëri", Urdhërit nr.531, datë 09.09.2022 të MAS "Për përcaktimin e planit mësimor për pakicat kombëtare në arsimin bazë",

ZVAP FINIQ - DROPULL

NJOFTON:

Kërkesën për personel mësimor nga Shkolla 9-vjeçare Finiq dhe Mesopotam për pozicionin mësues profili Ed.Fizik (Kurrikula Shqip dhe Greqisht), si pasojë e krijimit të vendit vakant për afatin: Kontratë 3-mujore dhe pas kalimit me sukses të

tremujorit të kohës së provës kontrata do të rinovohet deri në përfundim të vitit

shkollor 2022-2023.

ZVAP Finiq – Dropull njofton se Komisioni i Vlerësimit në ZVAP do të vijojë me procedurën e duhur ligjore për plotësimin me mësues profili Ed.Fizik (Kurrikula Shqip dhe Greqisht), me 12 orë profili në Shkollën 9-vjeçare Finiq dhe me 10 orë profili në Shkollën 9-vjeçare Mesopotam me kontratë me afat të caktuar, sipas Udhëzimit nr.12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë” ndryshuar me Udhëzimin nr.28, datë 03.08.2022 të MAS “Për një ndryshim në udhëzimin nr.12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar”.

Kandidatët e interesuar jashtë portalit, që plotësojnë kërkesat për pozicionin e mësuesit si më sipër, të paraqesin dokumentat përkatëse pranë ZVAP Finiq-Dropull deri më dt. 30.09.2022, për trajtim sipas legjislacionit në fuqi nga Komisioni i Vlerësimit të ZVAP.

DREJTORI

Ziso LLUCI

